



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Qershor 2024



SHQIPËRIA VLERËSOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN SI PARTNER I ANGAZHUAR NË LUFTËN KUNDËR NARKOTIKËVE

Ministri i Brendshëm Taulant Balla u takua me Drejtorin e Agjencisë së BE Kundër Drogës ku Shqipëria u vlerësua si një partner i angazhuar fuqimisht në luftën evropiane dhe globale kundër narkotikëve. “EMCDDA po mbështet Shqipërinë për ngritjen e Observatorit Kombëtar të Drogave dhe Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm”.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

01

KONFERENCA E 51 RAJONALE E INTERPOL PËR EVROPËN NË TIRANË



Ministri i Brendshëm Taulant Balla priti në takim Presidentin e Interpol, Ahmed Naser Al-Raisi me të cilin bisedoi për bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore e narkotikëve, kërcënimet kibernetike, përmirësimin e sigurisë në rajon e më gjerë, si dhe vendosjen para drejtësisë të personave në kërkim ndërkombëtar. Numri në rritje i ekipeve të operacioneve të përbashkëta konfirmon Shqipërinë si një anëtar të angazhuar dhe partner të besuar të INTERPOL.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

02

BERLIN, BALLA PRITET NGA MINISTRJA E BRENDSHME GJERMANE FAESER: BASHKËPUNIM I SHKËLQYER MES DY POLICIVE.



Ministri i Brendshëm Taulant Balla u prit në Berlin nga Ministria e Brendshme Federale e Gjermanisë, Nancy Faeser. Dy homologët e vunë theksin tek bashkëpunimi i shkëlqyer mes policive të dy shtetave. Këtu përfshihen operacionet e përbashkëta të tyre, por edhe në kuadër të operacioneve me Interpol, Europol etj., në luftën kundër krimit të organizuar, krimeve kibernetike dhe migracionit të paligjshëm.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

03



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Qershor 2024


ME MINISTRIN E DREJTËSISË E POLICISË ZVICERIANE: VLERËSOHET BASHKËPUNIMI DYPALËSH, PRIORITET EKSTRADIMET.

Ministri i Brendshëm Taulant Balla u takua në Bern, me Ministrin e Drejtësisë dhe Policisë të Zvicrës, Beat Jans, me të cilin bisedoi për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, narkotikëve dhe drogave sintetike si edhe migracionit të paligjshëm. Ministrat trajtuan gjithashtu si prioritet edhe çështjen e ekstradimeve të shtetasve që kërkohen nga drejtësia.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

04



ME NDIHMËS SEKRETARIN E SHTETIT, ROBINSON: MBËSHTETJA AMERIKANE NË FORCIMIN E KAPACITETEVE DHE SHKËMBIMIN E EKSPERIENCAVE

Ministri i Brendshëm Taulant Balla u prit Ndhmës Sekretari i Shtetit, Todd D. Robinson, me të cilin bisedoi mbi bashkëpunimin e shkëlqyer me agjencitë ligjzbatuese dhe programet e asistencës amerikane si DEA, INL dhe ICITAP.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

05



DEPARTAMENTI AMERIKAN CERTIFIKATË VLERËSIMI PËR KONTRIBUTIN E SHQIPËRISË NË MIKPRITJEN E QYTETARËVE AFGANË

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka vlerësuar kontributin e Shqipërisë në mikpritjen e qytetarëve afganë përgjatë procesit të zhvendosjes së tyre. Vlerësimi është dhënë nga përfaqësues të Zyrës për Koordinimin e Përpjekjeve për Zhvendosjen e Afganëve (CARE).

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

06



SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Qershor 2024

SAMITI I DREJTUESVE TË POLICISË SË KOMBEVE TË BASHKUARA: SFIDAT E SHUMTA NË FUSHËN E SIGURISË, KËRKOJNË PËRGJIGJE TË KOORDINUARA

Ministri i Brendshëm Taulant Balla u takua në Washington, me Kryetarin e Komisionit Special në Kongresin Amerikan John Moolennar. Balla zhvilloi një bisedë, që e konsideroi të frytshme, mbi sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e përdoruesve të internetit dhe rrjeteve sociale nga dhuna online.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

07

PAGA NË POLICINË E SHTETIT

GRADA
INSEKTOR

+20,120

Rritje Page + Ushqim

ISHTE

61,500 LEKË

BËHET

81,620 LEKË

RRITEN PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, AMP, GARDËS SË REPUBLIKËS, SHËRBIMIT ZJARRFIKËS E SHPËTIMIT

Në datë 26 qershor Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për rritjen e dytë të pagave, nga e cila përfitojnë punonjësit e Policisë, Gardës së Republikës, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Zjarrfikëses.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

08

“SMART CITY” PROJEKTI QË SYNON RITJEN E SIGURISË PUBLIKE DHE PARANDALIMIN E AKSIDENTEVE RRUGORE

Ministri i Brendshëm Taulant Balla, së bashku me drejtues të lartë të Policisë së Shtetit ndoqën një prezantim në Ministrinë e Brendshme, nga përfaqësuesit e Emirateve e Bashkuara Arabe të projektit përfundimtar “Smart City”. Projekti parashikon shtrirjen e kamerave të sigurisë, kamerave për leximin automatik të targave të automjeteve, të ndërlidhura mes tyre, nëpërmjet të cilave do të realizohet monitorimi dhe identifikimi në kohë reale i mjeteve që qarkullojnë në akset rrugore të cilësuara me interes prioritar për Policinë si dhe në Pikat Kufitare.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

09